

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Gani Avdiu e Milena Djerić – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.Sh.T. “Sh.” në Kaçanik, e cila është nën administrimin e A.K.P., të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtari i saj ligjor Xh.S., kundër të paditurit R.K. nga Kaçaniku, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik C.nr.138/11, të datës 27.01.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 01.11.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa paditëses N.SH.T “Sh.” në Kaçanik, e cila është nën administrimin e A.K.P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik C.nr.138/11, i datës 27.01.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar C.nr.138/11, të datës 27.01.2016, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses N.Sh.T “Sh.” në Kaçanik, e ushtruar me datën 13.11.2009, kundër të paditurit R.K. nga Kaçaniku, me të cilin ka kërkuar pagimin e borxhit në shumën prej 260 euro, si dhe shpenzimet e procedurës, në tërësi si të pabazuar. Me pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja në afat ligjor përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ankesën e paditëses ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta prish, ashtu që të vendos vetë në lidhje me këtë çështje juridike, ose që lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditëses, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja (tani paditësja) N.Sh.T “Sh.” në Kaçanik, me datë 13.11.2009, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar propozim për ekzekutim kundër debitorit (tani të paditurit) R.K. nga Kaçaniku, për shkak të borxhit në shumën 260.00 euro, me arsye sikurse në propozim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditores me datën 13.11.2009, ta nxjerrë aktvendimin E.nr.643/09, për ekzekutim. Kundër këtij aktvendimi, debitori me datën 09.06.2011, ka parashtruar kundërshtim. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të kundërshtimit të paraqitur nga debitori, ka nxjerrë konkluzionin EDA.nr.643/09, të datës 09.06.2011, me të cilin konkluzion është vënë jashtë fuqie aktvendimi për përmbarrimin i kësaj gjykate E.nr.643/09, i datës 13.11.2009, ndërsa propozimin e kreditores e ka konsideruar padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas tani padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.138/11, të datës 27.01.2016, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pabazuar. Ne arsyetim është theksuar se pas analizimit të provave dhe shkresave të lëndës, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar për arsye se nuk ka asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se paditësja ka lidhur kontratë me të paditurin, apo se i padituri e ka marrë në shfrytëzim lokalin afarist, cila ka qenë koha e shfrytëzimit të këtij lokali, si dhe për cilën periudhë kohore është ky borxh i pa paguar, për çka gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pathemelësinë e kërkesëpadisë së paditëses, është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave

materialo - juridike nga edhe ka rrjedhur se kërkespacia e paditëses në rastin konkret është e pabazuar.

Me nenin 262 të LMD parashihet se *“kreditore në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Zbatimi i kësaj dispozite në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkespacia e paditëses në rastin konkret është e pathemeltë, ngase paditësi nuk ka arritur që me prova konkrete dhe bindëse ta provojë faktin se këtu i padituri i ka borxh paditëses shumë e pretenduar sikurse në padi. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të cilin qëndrim në plotëni e përkrah edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosë edhe për shpenzimet e procedurës dhe në pajtim me dispozitën e nenit 450 të LPK.

Gjykata e Apelit i analizoi dhe mori për bazë edhe pretendimet e tjera ankimore por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.990/16, me datën 01.11.2019

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj